



Imagination
Ideas Inspiration
Innovation
Negotiation
Networking
Novelties
Necessities
Coordination
Concepts
Competences



Nr. 53

Viti i pestë i botimit

Tetor 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Metodologjia për identifikimin e impakteve negative në Zonat e Mbrojtura nëpërmjet analizave dhe anketimit individual
- Festohet Dita e Turizmit në Ulëz
- Monitorimi i procedurave të VNM nga Milieukontakt Shqipëri
- DENONCOJMË vrasjen e Ariut...
- Krimi mjedisor do të konsiderohet, dënohet dhe penalizohet si çdo krim tjetër
- Panairi i 15-të Ndërkombëtar i Ekologjisë "EKOBI 2017" nga Genci Kacori, SHKPSH
- Kuriozitete nga Zonat e Mbrojtura në Shqipëri
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
8 vjet më parë ...

...miratohet Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për Mbrojtjen e faunës së egër". Ligji ka për qëllim mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër, me synim për të ruajtur llojet, popullatat, habitatet ku ato jetojnë, rrugët e shtegtimin, si dhe për të siguruar kërkesat e tyre për ushqim, strehim dhe shumim. Fauna e egër në territorin e Republikës së Shqipërisë është pasuri kombëtare, që

administrohet dhe mbrohet me ligj, në përputhje edhe me konventat përkatëse ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ligj zbatohet për të gjitha llojet e nënlojet e faunës së egër, përfshirë vezët, foletë, të vegjlit dhe habitatet ku jetojnë të lira, përgjithmonë ose përkohësisht, në mjedise natyrore, tokësore e ujore, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fondi i faunës së egër përbëhet nga tërësia e llojeve të egra, nga popullatat e tyre, si dhe nga habitatet ku ato jetojnë në gjendje të egër.

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta © Foto INCA



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Vijon nga faqe 1

Mbrojtja e faunës së egër synon:

- a) ruajtjen e rimëkëmbjes e larmisë së llojeve dhe tërësinë e tyre gjenetike;
- b) mbrojtjen e habitateve, të rrugëve të shtegtit dhe të kushteve të shumimit të tyre;
- c) ruajtjen e integritetit të komuniteteve natyrore;
- ç) përdorimin e faunës së egër për qëllime studimore-shkencore, që sigurojnë rigjenerimin e tyre;
- d) rihyrjen e llojeve të faunës, të zhdukura apo të rrezikuara.

Ndër të tjera ligji shtjellon: Mbrojtja e llojeve të kërcënuara dhe endemike; Mbrojtja e habitateve, e rrugëve të shtegtit dhe e kushteve të shumimit; Mbrojtja nga efektet negative të ndryshimeve klimatike; Rimëkëmbja e popullatave të llojeve; Masa të veçanta për ruajtjen e shpendëve të egër; Masa shpëtuese; Veprime të ndaluara; Përdorimi i llojeve të faunës së egër, ndalimi i përdorimit të llojeve të mbrojtura, përdorimi i faunës së egër për qëllime shkencore, kulturore dhe edukuese; Mbajtja e faunës së egër në gjendje robërie; Veprimtaritë për shumimin në gjendje jo të lirë të faunës së egër; Planifikimi dhe vjelja e llojeve të faunës së egër; Rruajtja e numrit të popullatës së llojeve të faunës së egër; Inventarizimi i faunës së egër, vjelja; Monitorimi i faunës së egër; Kontrolli për mbrojtjen e faunës së egër, organet e kontrollit; Sanksionet...

...10 vjet më parë ...

...me VKM nr. 687, datë 19.10.2007 ekosistemi natyror "Divjakë-Karavasta" shpallet Park Kombëtar me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e PK, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sipërfaqe 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte statusin "Rezervat Strikt Natyror".

Njëherazi, ky territor, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka dhe statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994.

Në kuadër të bashkëpunimit me JICA për PK "Divjakë-Karavasta" është hartuar edhe Plani i Menaxhimit, i cili është miratuar me urdhr të ministrit të Mjedisit nr. 782, datë 30.12.2015...

...13 vjet më parë ...

...vendimi i KM nr. 680, datë 22.10.2004 shpalli sistemin ligatinor të VJOSË-NARTË "Peizazh Ujor/Tokësor i Mbrojtur", me sipërfaqe 19738 ha, nga e cila 7225 ha sipërfaqe ligatinore, 1167 ha pyjore, 7798 ha bujqësore, 2985 ha ujore dhe pjesa tjetër urbane e industriale. Në këtë territor u përfshi edhe ish Rezervati i Gjuetisë "Pishë Poro" (Vlorë), me sipërfaqe 1750 ha, i miratuar nga Ministria e Bujqësisë në vitin 1969.

Është për tu theksuar se me këtë VKM dhe sipas Planit të Menaxhimit, për herë të parë, u praktikuar dhe u miratua procesi i zonimit të territorit për zonat e mbrojtura.

PM "Vjosë-Nartë" ka plan menxhimi, i hartuar qysh më Dhjetor 2004, në kuadër të projektit MedWetCoast "Ruajtja e ligatinave dhe e ekosistemeve bregdetare në rajonin e Mesdheut", financuar nga GEF/UNDP. Ky plan nuk nuk u mbështet financiarisht për zbatimin e tij dhe i ka ardhur koha për rishikim...

...15 vjet më parë ...

...me VKM nr.531, datë 31.10.2002, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë", me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0 ha. Pjesë e kësaj zone Ramsar janë edhe territoret e përfshira në Parkun Kombëtar të Butrintit...

...3 vjet më parë ...

...më 13.10.2014, inagurohet zyrtarisht, në Korçë, Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë (RNBOP), pas një procesi të gjatë me aktorët më të rëndësishëm në rajon. Këshilli Koordinativ Ndërkombëtar (ICC) i Programit "Njeriu dhe Biosfera" të UNESCO ka miratuar nominimin e RNBOP në sesionin e 26 të mbajtur në Joenköping, Suedi, më 11.6.2014. Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë, përfshin basenin e liqenit të Ohrit dhe basenin e të dy liqeneve të Prespës, që lidhen me të. Sipërfaqja e rezervës në pjesën shqiptare e maqedonase të basenit të Ohrit dhe

Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2 nën-baseneve të liqeneve të Prespës është 446,244.52 ha. Kjo rezervë biosfere ndërtohet mbi tre shtylla që kanë të njëjtën rëndësi:

- Konservimi
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Shkenca, edukimi dhe ndërgjegjësimi (logjistika)

Në Rezervën Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë gjenden 454,000 banorë që jetojnë në 23 komuna e bashki në pjesën shqiptare dhe në gjashtë bashki në pjesën maqedonase. E gjithë zona karakterizohet nga një biodiversitet i pasur me specie të rralla e të rrezikuara në nivel global. Liqenet e Ohrit dhe Prespës, për shkak të gjenezës historike, kanë në gjirin e tyre specie të shumta endemike të cilat janë unike dhe gjenden vetëm në ekosistemin ujor dhe në ekosistemet tokësore për rreth liqeneve. Për këtë arsye në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar u krijuan parqet kombëtarë për ruajtjen e këtyre vlerave. Parqet Kombëtarë të Galicicës dhe Pelisterit në Maqedoni dhe Parku Kombëtar i Prespës në Shqipëri përfaqësojnë funksionin e konservimit të Rezervës së Biosferës. Në zonën qendrore të rezervës janë përfshirë rreth 14,000 ha ku ndalohet rreptësisht zhvillimi i çfarëdo aktiviteti njerëzor.

Zonat qendrore rrethohen nga një zonë buferike prej 140,429.27 ha në të cilën lejohen ato përdorime të burimeve natyrore që përforcojnë qëllimet e konservimit të zonës qendrore. Zona buferike rrethohet nga zona e tranzicionit me sipërfaqe 291,426.01 ha, në të cilën përdorimi i burimeve natyrore është subjekt i qëndrueshmërisë.


Objekti qendror në krejt Rezervën Ndërkufitare të Biosferës është zhvillimi i

përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në dobi të banorëve lokalë. Meqenëse rajoni në fjalë ka qenë i populluar prej më se 7000 vjet më parë, del nevoja që të rizbulohen njohuritë e mëparshme mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ekzistuese dhe të kombinohen me mjetet dhe masat moderne për përmirësimin e jetesës të banorëve vendas. Kjo detyrë adresohet sektorit shkencor, i cili në të dy vendet bregliqenore përfaqësohet nga universitete dhe institucione kërkimore të ndryshme.

Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Ohër-Prespë do të administrohet nga Komiteti i Menaxhimit të Basenit të Ohrit (OWMC), një institucion i krijuar në kuadrin e një marrëveshje dypalëshe nga të dy vendet bregliqenore, e nënshkruar në vitin 2004 dhe e ratifikuar nga parlamentet e të dy vendeve. OWMC mbështetet nga Sekretariati i Përbashkët me zyra në Pogradec dhe Ohër. Sekretariati i përbashkët do të jetë njësi që do të organizojë bashkëpunimin brenda kufijve të RNB të re.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.



PNR Liqeni i Ulzës © Foto INCA

Metodologjia për identifikimin e impakteve negative në Zonat e Mbrojtura nëpërmjet analizave dhe anketimit individual

Kukës 25 Shtator; Vlorë 27 Shtator; Prespë/ Korçë 2017 - Në funksion të iniciativës së Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri, mbi procesin e identifikimit të aktiviteteve me impakt negativ në 16 Zona të Mbrojtura në



Shqipëri, Instituti për Ruajtjen e Natyrës zhvilloi Trajnimet Rajonale mbi "Njohja dhe zbatimi i metodologjisë për identifikimin e impakteve negative në zonat e mbrojtura, nëpërmjet analizave dhe anketimit individual (plotësimi i pyetësorit)". Në trajnim merrnin pjesë organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës dhe përfaqësuesit e OJF-ve lokale të cilët janë përfshirë në identifikimin e impakteve negative në Zonat e Mbrojtura pilote të përzgjedhura.



Festohet Dita e Turizmit në Ulëz

Ulëz 27 Shtator 2017 - Me rastin e Ditës Botërore të Turizmit, Organizata "Miqësia Ulëz", pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e natyrës, në bashkëpunim me Bashkinë Mat, organizuan në Sheshin "Nënë Tereza" Ulëz, promovimin e vlerave natyrore të Parkut Natyror Rajonal "Liqeni i Ulës" dhe zhvillimit të turizmit nëpërmjet nxitjes dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile, komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi dhe promovimi për menaxhimin e përbashkët të Zonave të Mbrojtura, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit SENIOR-II të

Trajnimit kishte për qëllim njohjen e metodologjisë për identifikimin e impakteve negative në zonat e mbrojtura si dhe kryerjen e procesit të plotësimit të pyetësorëve individual.

Këto aktivitete zhvillohen në kuadër të projektit "Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura".

Pjesë e programit SENIOR II Albania (Senior Albania), zbatuar nga REC Shqipëri, financuar nga qeveria suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).

zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC Shqipëri) dhe financuar nga Ambasada Suedeze (Embassy Sweden of Tirana) dhe me partner bashkëpunimi Fondacionin CNVP.



Monitorimi i procedurave të VNM

nga Milieukontakt Albania

Më datë 6 shtator pritej të zhvillohej një dëgjese publike nga subjekti "JAMARBËR GROUP" për ndërtimin e një inceneratori për djegien e mbetjeve spitalore e të kafshëve, natyrisht me pjesëmarrjen e komunitetit të zonës, autoriteteve lokale si dhe organizatat mjedisore lehtësuara nga DRM Durrës.



Milieukontakt Shqipëri e ka ndjekur me shumë vëmendje këtë çështje dhe që në momentin e parë që jemi njoftuar për datën edhe orën e dëgjësës, me ndihmën e autoriteteve lokale është bërë i mundur njoftimi i banorëve që të jenë të pranishëm në dëgjësën publike.

Së pari po sqarojmë që subjekti 'JAMARBËR GROUP sh.p.k' është i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 15-03-2017 dhe themeluar më datë 13-03-2017 me numër NIPTIL71515507M.

"JAMARBËR GROUP" është pajisur me Deklaratë Mjedisore për të zhvilluar projektin: "Trajtimi i mbetjeve spitalore". Është kryer Dëgjesa me publikun për VNMTH me datë 14-04-2017. Njoftimi për organizimin e dëgjësës është bërë vetëm 2 ditë përpara takimit.

Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet është konsideruar me efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, i është kërkuar ti nënshtrohet procedurave për paisje

me Leje Mjedisore. Prandaj ky subjekt është pajisur me Leje Mjedisore TIPI B për aktivitetin "Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përmes incinererimit ose lëndfillimit si dhe Licensë të kategorisë III.2.B për grumbullim, transportim dhe asgjësim mbetjesh spitalore. Dëgjesa publike është mbajtur me datë 08-06-2017. Njoftimi për organizimin e dëgjësës është bërë vetëm 2 ditë përpara takimit.

Ndërkohë në datë 17.08.2017 Subjekti "JAMARBËR GROUP" aplikon përsëri për aktivitetin "Incenerim i mbetjeve duke përfshirë edhe mbetjet e kafshëve" dhe me datë 05-09-2017 pasi është plotësuar afati 20 ditor i publikimit në WEB-in e AKM, dhe dosja i është deleguar DRM Durrës për zhvillimin e dëgjësës me publikun për VNMTH dhe për LEJE TIPI A ose B (mbi 1 ton/ore është LEJE TIPI A).

Në këtë fazë të fundit të aplikimit, monitoruar edhe nga MIA u konstatuan shumë parregullsia, dokumentacionet dhe raportet që administratori i subjektit kishte dorëzuar kishin shumë mangësi. Në një letër dërguar DRM Durrës i kemi renditur disa nga pikat që nuk sqarohen në raport:

Datën e saktë kur subjekti ka bërë kërkesë për VNMTH,

A kishte patur proces konsultimi me aktorët përkatës për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VNMTH dhe me kë?

Raporti paraprak nuk përmban asnjë (ose percipet disa) nga pikat që kërkon

Vijon në faqe 6



Vijon nga faqe 5 ligji të jenë në raportin e thelluar.

Cila kompani apo ekspert ka përgatitur këtë "raport"?

Nuk bazohej fare në dokumentat dhe politika strategjike të bashkisë (PVMMNU).

Megjithatë edhe pse me gjithë këto mangësi u desh ndërhyrja dhe protesta e banorëve, ku rreth 100 banorë nënshkruan dhe një petition kundërshtues, sigurisht i mbështetur nga MIA, ku në asnjë çast nuk mungoi informimi dhe ndihma jonë për banorët e zonës duke i sqaruar arsyet pse nuk duhet të lejohet ndërtimi i inceneratorit, ku më e rëndësishmja është shëndeti i tyre.

Takimi nuk u zhvillua dhe policia së bashku me punonjës të bashkisë bënë kontrollin e magazinës, mbajtën një akt kontrolli duke bllokuar aktivitetin deri në marrjen e një vendimi. Dokumentacioni ju kalua edhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Lajmi u pasqyrua edhe në median vizive dhe atë të shkruar.

Në ditët në vazhdim Bashkia Shijak i dërgon një letër DRM Durrës në përgjigje të shkresës për njoftim të dëgjuesës publike ku renditen disa arsye dhe qëndrimi kundër i bashkisë ndaj një

investimit të tillë. Po atë ditë MIA i dërgon një shkresë AKM, DRM Durrës me mendime/reflektim mbi njoftimin në fjalë.

Pas shumë përpjekjeve dhe ndjekjes së çështjes hap pas hapi morëm edhe lajmin e mirë që leja mjedisore nuk do jepej, procedura është pezulluar dhe konsultimi publik ka dështuar.

Si përfundim gjejmë rastin të falenderojmë autoritetet lokale që e mbështetën nismën tonë, komunitetin që iu përgjigjën thirrjes madje të shumtë në numër, duke na treguar që të bashkuar dhe me një qëllim të përbashket, për të mbrojtur shëndetin si dhe mjedisin ku jetojnë mbi të gjitha është një

detyrë morale e nuk duhet të ndihemi aspak inferiorë para subjekteve që investojnë miliona dollarë për të marrë jetë njerëzish.

Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit: "OSHC-të praktikojnë VNM-në në të gjitha fazat", mbështetur financiarisht nga Projekti "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" (CO-SEED) me fonde të Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri.




DENONCOJMË vrasjen e Ariut

Jemi hasur me një artikull të postuar online nga një portal shqiptar (JOQ) i cili raporton vrasjen e një individi të ariut të murrmë në fshatin Sterdok të qarkut të Dibrës. Preteksti është, "E vramë se na mori bukën e gojës", duke iu referuar dëmeve që ariu u ka bërë të mbjellave të fshatarëve.

Nga lajmërimet dhe rastet e arkivuara më parë, mendohet se ky episod daton prej rreth një muaji, edhe pse artikulli është postuar vetëm pak ditë më parë.

Kjo është Kriminale!...Duhet të reagojnë ashpër Ministria e Brendshme dhe Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit...

Burimi: <http://joq.al/artikull/247095.html>



Krimi mjedisor do të konsiderohet, dënohet dhe penalizohet si çdo krim tjetër

Në prag të fillimit të aksionit të madh të pastrimit të Shqipërisë, ministri Blendi Klossi dhe Fatmir Xhafaj zhvilluan takim me prefektët dhe drejtuesit e policisë në qarqe, për t'u bërë me dije se do të jenë aktorët kryesorë në terren të zbatimit të ligjit të ndalimit të krimit mjedisor. "Kush dëmton mjedisin tonë të përbashkët, që është malli ynë i përbashkët, pasuria jonë e përbashkët, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar turizmin, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar ekonominë, mundësia jonë e përbashkët për të zhvilluar mirëqënien, duhet të dënohet, të penalizohet", deklaroi Klossi.

Ligji do të ashpërsohet, theksoi ai, duke u kerkuar drejtuesve të policisë të jenë me të njëjtin vullnet të angazhuar në këtë operacion, ashtu si në operacionin e ndalimit të vjedhjes së energjisë elektrike. Klossi u kërkoi drejtuesve të policisë, që çdo biznes apo individ që ndot mjedisin të trajtohet dhe penalizohet njësoj sipas ligjit.

"Historia që një biznes që ndot mjedisin apo krijon ndotje akustike, nuk penalizohet dhe tjetri pas tij po, duhet të marrë fund njëherë e

përgjithmonë", tha deklaroi Klossi.

"Ne kemi nevojë të vendosim një legjislacion penalizues, edhe rregulla dhe dënime të barabartë në zbatim të ligjit". Ashpërsimi i ligjit kundër krimit mjedisor, do të bëhet edhe në funksion të një turizmi që do të ndryshojë qasje, deklaroi Klossi.

Ndërsa ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, tha se turizmi konsiderohet prioritet thelbësor për qeverisjen për këtë mandat të ri e do të ketë mbështetjen e nevojshme. Ai shtoi se përgatitjet duhet të nisnin që sot.

"Policia dhe prefektët duhet të përgatiten për mbështetje të fortë të strukturave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, lidhur me fazën përgatitore, që nga pastrimi i mjediseve dhe masave të tjera që duhet të merren", shtoi Ministri i Brendshëm.

Xhafaj tha se turizmi konsiderohet prioritet thelbësor për qeverisjen për këtë mandat të ri e do të ketë mbështetjen e nevojshme.

Burimi: Balkan Web

Panairi i 15-të Ndërkombëtar i Ekologjisë "EKOBIS 2017"

nga Genci Kacori, SHKPSH

Nga data 14 deri më 16 shtator 2017, në ambientet e Qendrës së Sportit dhe Rekreacionit "Luka" në Bihać, Bosnje-Herzegovinë, u organizua Panairi i 15-të Ndërkombëtar i Ekologjisë "EKOBIS 2017". Në Panair i ishte rezervuar një hapësirë e veçantë ekspozimi, Rrjetit të Parqeve Dinarikë. Objektivat e Panairit, i cili është organizuar me sukses për 14 vjet, ishin promovimi dhe vlerësimi i produkteve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve për zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë arsye, Panairi synonte të gjithë aktorët që kanë influencë dhe ndikime në këtë fushë - industria, qeveria dhe sektori publik, institucionet arsimore, mediat, sektori civil dhe qytetarët.



ShKPSH
Shoqata Kombëtare e
Parqeve të Shqipërisë

Panairi "EKOBIS 2017" i ishte dedikuar UJIT, veçanërisht për natyrën e tij të përgjithshme natyrore, biologjike, ekonomike dhe mjedisore, për qytetin e Bihaćit dhe kantonin Una Sana. Shoqata Kombëtare e Parqeve të Shqipërisë morri pjesë në Panair me materiale promovuese, mbi zonat e mbrojtura të vendit tonë dhe për Luginën e Valbonës, të përgatitura në bashkëpunim dhe me ndihmën e Shoqatës "ILIRIA".

Pjesëmarrja në Panair e Shoqatës tonë u bë e mundur me mbështetjen e zotit Ljubiša Pejović, zyrtar për komunikimin i Rrjetit të Parqeve Dinarikë, të cilin e falenderojmë për kontributin e dhënë.

Kuriozitete nga Zonat e Mbrojtura në Shqipëri

Monumentet e Natyrës Rrobulli i Zeleshjes

Gjatë inspektimit në Monumentet e Natyrës Rrobulli i Zeleshjes (Pinus heldreichii), Monument Natyre me një sip.1.5ha me një peisazh mahnitës e të rrallë gjendja e të cilit ruhet ende mirë. Ai ndodhet 1677m mbi nivelin e detit.

Mështekna e Zavalinës (Betula Pendula), përfaqëson një sipërfaqe pyjore mështekne me rreth 7,5 ha. Mështekna është dru karakteristikë për këtë territor. Mosha e drurëve është 130 vjeçare. Lartësia është rreth 16 m, diametri i trungut arrin deri 22 cm. Është në gjendje të mirë. Ndodhet në një lartësi rreth 1000 - 1170 m mbi nivelin e detit.



Specie të reja me interes për shkencën në Vjosë

I kërcënuar nga hidrocentralet, lumi i fundit i egër në Europë zbulon sekretet e tij

Një ekip ndërkombëtar shkencëtarësh ka regjistruar gjatë një ekspedite të shkurtër qindra gjallesa të reja në lumin Vjosë, dy prej të cilave të panjohura më parë për shkencën - një zbulim i jashtëzakonshëm që shton zërat për mbrojtjen e basenit të tij nga projektet për ndërtimin e hidrocentraleve.

“Është e pabesueshme çfarë kemi zbuluar vetëm në një javë,” u shpreh Fritz Schiemer nga Universiteti i Vjenës duke iu referuar zbulimit të një lloji të ri peshku dhe të një insekti ujor të panjohur më parë nga shkencëtarët.

Burimi Web



NJOFTIME

3 Tetor - Dita Botërore e Habitave

4 Tetor - Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve

13 Tetor - Dita Ndërkombëtare për Pakësimin e Fatkeqsive Natyrore

16 Tetor - Dita Botërore e Ushqimit

24 Tetor - Dita Ndërkombëtare e Veprimeve për Klimën

1 - Për të lexuar “Ditari i Natyrës” në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi “Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë”



Organizatrat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Adr.:Rruga “Islam Alla”
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania

Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org

www.inca-al.org;
info@inca-al.org;
www.facebook.com/inca.albania

INCA ALBANIA

